

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6756
E shtunë, 12 nëntor 2022
çmimi 0.40

Abazi: Qeveria, qasje të gabuar për kërkesat e ndërkombëtarëve



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA VJOSA OSMANI DHE KRYEMINISTRI ALBIN KURTI JANË PRITUR NË TAKIM NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS FRANCEZE, EMMANUEL MACRON, NË PALLATIN ELYSEE

OSMANI DHE KURTI I THONË PO PROPOZIMIT FRANKO-GJERMAN

FAQE 4

"Propozimi franko-gjerman shërben si bazë e mirë për diskutime të mëtejshme [në dialogun Kosovë - Serbi]", kanë deklaruar presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti gjatë takimit me presidentin francez Emmanuel Macron, është thënë në komunikatën e përbashkët të lëshuar nga Presidenca dhe Qeveria e Kosovës. Aty është theksuar se Osmani dhe Kurti e kanë falënderuar presidentin Macron për angazhimin e Francës, në bashkëpunim me Gjermaninë, për dinamizimin e procesit të dialogut



INTERVISTA E MUHAMED MAVRAJ NË EDICIONIN SPECIAL TË KLAN KOSOVËS MË 8 NËNTOR 2022

ME KËTË QEVERI KATASTROFË BRENDË E KATASTROFË JASHTË! PLANI RUS I ZVARRITJES SË KOSOVËS PO FUNKSIONON!

FAQE 8-11

- Po të investohej në përcarjen e deputetëve serbë sa është investuar ta zëmë për përcarjen e profesorëve, arsimtarëve dhe shtresave të tjera të shoqërisë sonë, ne, të paktën, tani do t'i kishim tre deputetë serbë në anën tonë, mjaftueshëm sa për të ta ndryshuar Kushtetutën e Kosovës.



- Në Serbi e Mal të Zi nuk kam shkuar dhe nuk shkoj, sepse e di që më arrestojnë



ESCOBARI KËRKON QË KOSOVA TA PRANOJË KËRKESËN PËR TARGA DHE PËR ASOCIACIONIN


FAQE 5



AMBASADORI FRANCEZ: I PËRKRAHIM VIZAT, POR PËR DISA ÇËSHTJE DUHET TË DISKUTOHET

FAQE 3

AKTUALE



KONTROLLI I SENATIT ENDE I PAPËRCAKTUAR, REPUBLIKANËT I AFROHEN SHUMICËS NË DHOMËN E PËRFAQËSUESVE

F. 2

DEPUTETI AUSTRIAK: TË GJITHA SHTETET E BE-SË DHE SERBIA DUHET TA NJOHIN KOSOVËN

F. 3

KMSHK-JA ORGANIZOI TRYEZË DISKUTIMI ME GAZETARËT E ANAMORAVËS

F. 6

EKONOMI



MARTIN BERISHAJ S'DËSHMON NË KOMISION HETIMOR, KËRKON T'I SHTYHET RAPORTIMI

F. 8

MINISTRIA E TREGTISË DO T'I PËRCJELLË NAFTËTARËT NË RAST TË NGRITJES SË PAARSYESHME TË ÇMIMEVE

F. 8

SPORT



GJIMNASTET E KOSOVËS KTHEHEN NGA PORTUGALIA, SHKËLQEN BORA HOTI

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kontrolli i Senatit ende i papërcaktuar, republikanët i afrohen shumicës në Dhomën e Përfaqësuesve

WASHINGTON, 11 NËNTOR - Zyrtarët zgjedhorë në Arizona dhe Nevada kanë vazhduar edhe të premtën të numërojnë qindra-mijëra fletëvotimi që mund ta përcaktojnë kontrollin e Senatit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), një proces që, sipas tyre, mund të zgjasë për ditë të tëra.

Nëse as demokratët as republikanët nuk i fitojnë të dyja këto shtete, ndarja e barabartë do ta transformonte balotazhin e 6 dhjetorit në Xhorxhia në një betejë për Senatin, Dhoma e Kongresit që voton për kandidatët e gjyqësorit të presidentit Joe Biden.

Në luftën për Dhomën e Përfaqësuesve, republikanët janë duke iu afruar marrjes së

kontrollit nga demokratët e Bidenit. Kontrolli i Dhomës së Përfaqësuesve do t'u jepte republikanëve të drejtën e vetos mbi programin legjislativ të presidentit Biden si edhe mundësinë që të nisin hetime që mund të jenë të dëmshme për administratën e tij.

Republikanët kishin siguruar të paktën 211 nga 218 vendet e Dhomës së Përfaqësuesve që u nevojiten për shumicën të enjten vonë, ndërsa demokratët kishin fituar 197. Kjo lë 27 gara ende të papërcaktuara, përfshirë disa gara të ngushta. Udhëheqësi i republikanëve në Dhomën e Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, ka njoftuar se do të kandidojë për postin e kryetarit nëse republikanët marrin shumicën, një rezultat që ai

e ka përshkruar si të pashmangshëm.

Demokratët kanë frenuar një "valë të kuqe" republikane që ishte parashikuar para zgjedhjeve. Republikanët kishin kritikuar Bidenin për rritjen e inflacionit dhe rritjen e nivelit të krimit.

Presidenti demokrat i ka karakterizuar zgjedhjet si një luftë për ta shpëtuar demokracinë pasi kandidatët republikanë mbështetën pretendimin e rremë të ish-presidentit Donal Trump se zgjedhjet e vitit 2020, të cilat Bideni i kishte fituar, ishin të manipuluar. Demokratët i kanë etiketuar republikanët si ekstremistë, duke përmendur, mes të tjerash, si argument vendimin e Gjykatës së Lartë për ta eliminuar të drejtën mbarëkombëtare për abortin.



Disa nga kandidatët e mbështetur nga Trumpi kanë humbur gara të rëndësishme të martën, duke

bërë që disa republikanë ta fajësojnë stilin e tij përçarës për rezultatet zhgënjyese të partisë.

Bideni shkon në Egjipt për konferencën e OKB-së për ndryshimet klimatike

KAJRO, 11 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka mbërritur të premtën në Egjipt. Ai do të marrë pjesë në punimet e Konferencës së OKB-së për Ndryshimet Klimatike. Në fjalimin që do të mbajë në këtë konferencë, ai do të shpjegojë se si Shtetet e Bashkuara janë duke e trajtuar krizën klimatike brenda dhe jashtë vendit. Por aktivistët e mjedisit thonë se vendet e pasura duhet të përqendrohen në përbushjen e premtimit të tyre prej 100 miliardë dollarësh në vit për t'i kompensuar humbjet dhe dëmet nga ndryshimet klimatike. Presidenti Biden në takimin historik të Kombeve të Bashkuara për klimën do të diskutojë për një numër çështjesh, kanë thënë zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë. "Ai do të flasë mbi angazhimin e tij personal për trajtimin e krizës klimatike. Ai do të nxjerrë në pah disa nga përparimet që kanë bërë Shtetet e Bashkuara, si këtu në vend ashtu edhe në mobilizimin e të tjerëve për çështjen e klimës në mbarë botën. Ai do ta theksojë nevojën për të ecur më tej e më



shpejt për t'i ndihmuar komunitetet më të pambrojtura në botë, veçanërisht për t'i nxitur ekonominë kryesore të botës që ta ulin në mënyrë drastike nivelin e çlirimt të gazeve në këtë dekadë vendimtare", ka thënë Jake Sullivan, Këshilltar i Sigurisë Kombëtare.

Por në një vit kur përmbytjet, valët e të nxehtësisë dhe moti ekstrem kanë shkaktuar dëme të rënda, aktivistët mjedisorë duan të shohin diçka tjetër. Në vitin 2015, 196 palë kanë nënshkruar Marrëveshjen e Parisit, një traktat ligjërish i

detyrueshëm që, ndër të tjera, parashikonte që vendet e pasura të ofrojnë 100 miliardë dollarë në vit për t'i ndihmuar vendet në zhvillim të përballesh me humbjet dhe dëmet nga ndryshimet klimatike. Por, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, e cila ka monitoruar këtë çështje, thotë se ky objektiv ende nuk është arritur. "Do të ketë një vëmendje të madhe për humbjet dhe dëmet në veçanti, të cilat kanë qenë pjesë e diskutimeve për një kohë të gjatë", ka thënë Angela Churie Kallhaug

nga Fondi i Mbrojtjes së Mjedisit. Disa delegatë, si ministri i Jashtëm i Pakistanit, kanë dalë me propozime të reja për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Përmbytjet vdekjeprurëse kanë shkaktuar dëme të rënda në këtë vend në fillim të këtij viti. "Një zgjidhje për këtë mund të jetë falja e borxheve të vendeve në zhvillim nga vendet e zhvilluara, në mënyrë që fondet e parashikuara për pagimin e borxheve të mund të përdoren për rindërtimin e zonave të dëmtuara, tranzicionin tonë energjetik, dhe marrjen e masave për t'i parandaluar dëmet nga ndryshimi i klimës në të ardhmen. Pra, vendet e zhvilluara, pa pasur nevojë të transferojnë para, do të jenë në gjendje të thonë se po përbushin angazhimet e tyre në këtë front", ka thënë Bilawal Bhutto Zardari, ministër i Jashtëm i Pakistanit. Në vend të kësaj, zyrtarët amerikanë janë duke u përqendruar në reklamimin e efekteve ekonomike të Ligjit të reduktimit të inflacionit, të miratuar së fundmi, i cili parashikon investimin e rreth 375

miliardë dollarëve gjatë 10 vjetëve të ardhshme për t'i luftuar ndryshimet klimatike. "Vetë ligji e trajton këtë çështje nga pikëpamja ekonomike. Varet se si i shihni burimet që keni në dispozicion, si mund të përdoren ato për ta trajtuar çështjen e ndryshimit të klimës, por edhe si mund të sjellin përfitime të jashtëzakonshme ekonomike. Kjo mund të zbatohet si në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet e zhvilluar të botës", ka thënë Gina McCarthy, ish-këshilltare amerikane për klimën. Nuk është e qartë se si do të pritet ky mesazh. Të mërkurën, i dërguari amerikan për klimën, John Kerry, është kritikuar në konferencë, derisa ka folur me delegatët për një plan për ta financuar tranzicionin e energjisë së pastër në vendet e varfra nëpërmjet financimit privat, jo publik. Pas konferencës së OKB-së për klimën në Sharm el Sheikh, presidenti Biden do të shkojë në Azinë Lindore për të marrë pjesë në dy takime të tjera ndërkombëtare.

Suedia padit dy persona, spiunonin për Rusinë

STOKHOLM, 11 NËNTOR - Prokurorët suedezë kanë paditur të premtën dy vëllezër për spiunazh të rëndë në emër të Rusisë, duke thënë se krimi i supozuar mund të jetë i dëmshëm për sigurinë e vendit.

Personat, 42 dhe 35 vjeç, janë të ndaluar që nga viti i kaluar

dhe më parë kanë mohuar të gjitha akuzat. E përditshmja suedeze "Dagens Nyheter" ka raportuar, duke cituar burime, se një nga burrat ka punuar më parë në disa nga agjencitë më të rëndësishme të inteligjencës suedeze.

"Dyshimi ka të bëjë me kriminalitet shumë të rëndë të drejtuar kundër sistemit të

inteligjencës dhe sigurisë suedeze. Vepra penale është e rëndë pasi ka të bëjë me rrethana të një rëndësie të madhe. Informacioni që është marrë, transmetuar dhe zbuluar mund të rezultojë në dëm të sigurisë së Suedisë, nëse bie në duart e një fuqie të huaj", ka thënë në një deklaratë prokuroria suedeze.



FSK-së i shtohen edhe 311 ushtarë të rinj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Të premtën është mbajtur ceremonia e betimit të 311 ushtarëve të rinj të cilët përbëjnë grupin më të madh të të certifikuarve ndonjëherë në ushtrinë e shtetit tonë. Në ceremoninë e betimit të rekrutëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të mbajtur në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale dhe përfaqësues ndërkombëtarë.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, u ka thënë ushtarëve të rinj se gjatë shërbimit brenda dhe jashtë vendit, ecni gjithmonë me kokën lart. "Dijeni mirë që në venat tuaja keni ADN-në e UÇK-së, keni ADN-në e komandantit legjendar Adem Jashari. Ushtria e Adem Jasharit nuk dorëzohet, nuk kthehet prapa, është e pathyeshme dhe e pamposhtur. Mos harroni kurrë, që më e rëndësishmja është t'i shërbeni popullit dhe popullin ta keni me vete. Përderisa jeni në rrugën e dëshmorëve, në rrugën e UÇK-së, populli është me ju dhe ju jeni me popullin", ka thënë Mehaj, duke shtuar se grupi i ushtarëve të rinj është shumë i veçantë. "Jeni grupi më i madh që është certifikuar ndonjëherë në ushtrinë tonë, pra gjithsej 311. Sa i përket personelit me ju, arrijmë në 1 240 ushtarë brenda 18 muajve. Sot kur po përmbyllim me sukses këtë proces të

rekrutimit, ju njoftoj që konkursin e radhës për pranimin e 612 ushtarëve të rinj do ta hapim me datë 28 nëntor. Kjo është e nevojshme, kjo është e domosdoshme për ta zhvilluar edhe më tutje ushtrinë tonë dhe për t'i forcuar kapacitetet tona në mbrojtje të vendit dhe për garantim të paqes", ka thënë Mehaj.

Ai ka theksuar se rrugëtimi ynë do të ishte i pamundur pa aleatët tanë. "Populli ynë thotë 'Shtëpia jonë është e mikut dhe e Zotit', prandaj bashkëpunimin dhe mirënjohjen për partnerët tanë duhet ta kemi gjithmonë në rend të parë. Bashkëpunimi dhe koordinimi me ShBA-në është jetësor për ne. Pa ndihmën dhe përkrahjen e saj nuk do t'ia dilnim dot. Borxhin ndaj saj nuk mund ta shlyejmë asnjëherë. Anëtarësimi në NATO dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë është synimi ynë. Ne do ta përmbushim çdo detyrë e obligim që të jemi pjesë e kësaj familje të madhe", ka thënë ministri Mehaj.

Konjufca: Ushtria është e shtetit, shteti është i popullit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i ka përgëzuar rekrutët e rinj për marrjen e detyrës, ndërsa ka shtuar se ushtria po rritet e po forcohet në Kosovën sovranë dhe demokratike.

Kreu i Kuvendit ka thënë se



ushtria është e shtetit e shteti është i popullit. Ai ka bërë me dije se për këtë shtet është dashur shumë mund, sakrificë dhe përpjekje, që kulmoi me luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për mbrojtjen e vendit, çlirimin e atdheut dhe largimin e okupatorit serb. "Shteti ynë është i barabartë për të gjithë qytetarët tanë, pa dallim etnie, gjinie, feje apo përkatësie tjetër. Dhe kjo është një vlerë që u arrit me vështirësi dhe mençuri. Por për ta mbrojtur lirinë e shtetit tonë e kemi FSK-në, e cila po ndërtohet sipas principeve të një ushtrie moderne dhe profesionale", ka

thënë Konjufca.

I pari i Kuvendit ka treguar se Kosova është e vetëdijshme se çdo arritje e saj është bërë bashkë me miqtë tanë të çmuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera të botës demokratike evropiane e perëndimore. "Prandaj orientimi ynë është i qartë. Ne duam të jemi pjesë e Aleancës Ushtarake të Atlantikut Verior - Aleancës më të fuqishme në botë, e cila përfshin ushtritë e vendeve demokratike. 23 vjet më parë ishte pikërisht NATO-ja e cila me bombardimet e saj ndali gjenocidin e Serbisë mbi

popullin tonë", ka deklaruar Konjufca, duke shtuar se Kosova nuk është shtet që ka pretendime territoriale, por ndihet e kërcënuar nga pretendimet e Serbisë.

Në fjalën e tij kryetari Konjufca ka përmendur edhe agresionin rus në Ukrainë, duke potencuar se Kosova është rreshtuar përkrah popullit ukrainas dhe luftës së tij të drejtë kundër okupimit rus. Ai ka thënë se nuk mund të ketë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në tokën evropiane pa hequr dorë Rusia nga Ukraina dhe Serbia nga Kosova.




Deputeti austriak: Të gjitha shtetet e BE-së dhe Serbia duhet ta njohin Kosovën

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Deputeti austriak Helmut Brandstatter ka thënë se të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian (BE) duhet ta njohin pavarësinë e Kosovës. Ai ka shtuar se Kosovën duhet ta njohë edhe Serbia. Këto komente

ai i ka bërë pas një takimi që ka zhvilluar me deputetin e PDK-së, Enver Hoxhaj, në Parlamentin e Austrisë. "Sot takova Enver Hoxhajn në parlamentin austriak. U pajtuam se të gjitha shtetet e BE-së dhe Serbia duhet ta njohin

Republikën e Kosovës. Tani kemi mungesë lufte, por na duhet paqja e përhershme në rajonin e Ballkanit, i cili është pjesë e rëndësishme e Evropës", ka shkruar në "Twitter" deputeti austriak Helmut Brandstatter.





PRESIDENTJA VJOSA OSMANI DHE KRYEMINISTRI ALBIN KURTI JANË PRITUR NË TAKIM NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS FRANCEZE, EMMANUEL MACRON, NË PALLATIN ELYSEE

Osmani dhe Kurti i thonë po propozimit franko-gjerman

“Propozimi franko-gjerman shërben si bazë e mirë për diskutime të mëtejshme [në dialogun Kosovë Serbi]”, kështu kanë deklaruar presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti gjatë takimit me presidentin francez Emmanuel Macron, është thënë në komunikatën e përbashkët të lëshuar nga Presidenca dhe Qeveria e Kosovës. Aty është theksuar se Osmani dhe Kurti e kanë falënderuar presidentin Macron për angazhimin e Francës, në bashkëpunim me Gjermaninë, për dinamizimin e procesit të dialogut

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PARIS, 11 NËNTOR - Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti janë pritur në takim nga presidenti i Republikës franceze, Emmanuel Macron, në Pallatin Elysee. “Në takim me presidentin Macron, presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë diskutuar për thellimin e marrëdhënieve bilaterale në mes të dy shteteve, dinamizimin e dialogut Kosovë - Serbi si dhe zhvillimet e fundit në Kosovë,

rajon dhe Evropë”, është thënë në komunikatën e përbashkët të lëshuar nga Presidenca dhe Qeveria e Kosovës.

Sa i përket dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Osmani dhe Kurti e kanë falënderuar presidentin Macron për angazhimin e Francës, në bashkëpunim me Gjermaninë, për dinamizimin e këtij procesi. Presidentja ka ritheksuar përkushtimin e plotë të institucioneve të Kosovës në procesin e dialogut, të bazuar në ruajtjen e sovranitetit, rendit

kushtetues, integritetit territorial dhe funksionalitetit të Kosovës, të cilët janë të paprekshëm. “Në takim, presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë potencuar se Kosova ka propozuar kornizën e përgjithshme të marrëveshjes, ndërsa kanë deklaruar se propozimi franko-gjerman shërben si bazë e mirë për diskutime të mëtejshme”, është thënë në komunikatë. Presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë folur edhe për zhvillimet e fundit në veri të vendit, duke theksuar se institucionet e Republikës së Kosovës mbeten të përkushtuara për paqe, stabilitet dhe garantimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët e vendit. Në këtë drejtim, siç është bërë me dije në komunikatë, presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë përmendur tendencat destabilizuese të Serbisë përmes

fuqizimit të strukturave ilegale të saj në Kosovë, frikësimit të qytetarëve serbë dhe nxitjes së grupeve kriminale për ta cenuar rendin dhe ligjin në veri. Presidentja dhe kryeministri kanë thënë se Kosova do të vazhdojë të jetë e koordinuar me partnerët ndërkombëtarë për adresimin e sfidave të sigurisë. Osmani dhe Kurti kanë thënë se Kosova vazhdon të jetë shembull në rajon dhe më gjerë sa i përket mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve joshumicë. Presidentja Osmani ka thënë se kjo është arritje e Kosovës dhe aleatëve perëndimorë, prandaj ka theksuar nevojën për veprime të përbashkëta për t’i ruajtur këto të arritura. Më tej, Osmani dhe Kurti kanë potencuar se Kosova është partnere e besueshme dhe kredibile e Francës dhe aleatëve të tjerë euroatlantikë, dhe se forcimi i pozitës ndërkombëtare të saj është vlerë e shtuar për komunitetin ndërkombëtar dhe

botën demokratike. Në këtë drejtim ajo ka folur për hapat konkretë të ndërmarrë nga institucionet e Kosovës për anëtarësim në strukturat euroatlantike. Presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë kërkuar që mbështetja e Francës të vazhdojë edhe për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, pastaj në programin e Partneritetit për Paqe, si hap i parë drejt anëtarësimin të plotë në NATO si dhe aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Bashkim Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Në takim me homologun Macron, presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti kanë folur edhe për rëndësinë e përfundimit të procesit të liberalizimit të vizave përgjatë Presidencës Çeke të Këshillit të BE-së, vendim i cili do të kontribuojë në forcimin e kredibilitetit të BE-së.

Escobari kërkon që Kosova ta pranojë kërkesën për targa dhe për asociacionin



PRISHTINË, 11 NËNTOR - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Kosova duhet t'i përmbushë kërkesat perëndimore për çështjen e targave të makinave dhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbisë i është bërë e qartë se tërheqja e serbëve nga institucionet e Kosovës është e padobishme.

Në një intervistë me "Zërin e Amerikës", Escobari e ka vlerësuar mjaft të rrezikshme situatën në veriun e Kosovës, pasi që institucionet vendase kanë mbetur pa punonjës serbë, të cilët janë tërhequr për shkak

të mospajtimeve me vendimin e qeverisë për konvertimin e targave të makinave të lëshuara nga Serbia. "Ne kemi qenë shumë të qartë dhe të hapur se çfarë presim nga të dyja palët. Nga pala e Kosovës kemi kërkuar një periudhë njëvjeçare të zbatimit për të bërë një fushatë publike të njoftimit dhe për ta përgatitur komunitetin e prekur, që të jetë i gatshëm t'i ndërrojë targarat e makinave. Ne, po ashtu, po u bëjmë thirrjeve që të fillojnë ta vënë çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në rend dite. Kjo është një kërkesë. Nga pikëpamja jonë dhe ajo e

partnerëve të Quintit, kjo është një kërkesë dhe ne do të ngulim këmbë. Nga pala serbe, ne mendojmë se çdo protestë duhet të jetë paqësore dhe largimi i serbëve nga institucionet nuk është i dobishëm. U bëj thirrje palëve që të jenë gati t'i përmbushin këto çështje menjëherë", ka deklaruar ai.

Escobari ka thënë se koha është për më shumë dialog dhe se Shtetet e Bashkuara kanë qenë shumë të qarta gjatë procesit të bisedimeve se cilat janë pritshmëritë nga pala e Kosovës. "Ne kemi qenë, po ashtu, shumë të qartë me palën serbe, se

pajtohemi që çështja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë në rendin e ditës. Unë kam biseduar me një gamë të gjerë zërash brenda Kosovës që e mbështesin këtë dhe janë të vullnetshëm ta ndihmojnë Kosovën për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare për këtë çështje", ka theksuar Escobari.

Janë rreth 9 000 makina me targa të tilla që qarkullojnë në veriun e Kosovës - të banuar me shumicë serbe - që nga paslufta më 1999. Qeveria e Kosovës kërkon që ato të zëvendësohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës. Plani i saj parashihet të zbatohet në tri

faza: e para, qortimi i shoferëve; e dyta, dënimi i shoferëve me 150 euro gjobë; e treta, shpërndarja e targave provuese.

Shumica e serbëve në veri, të mbështetur nga Beogradi zyrtar, e kundërshtojnë planin, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës. Në shenjë kundërshtimi ndaj zbatimit të tij, serbët e veriut kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës. Ata kanë thënë se nuk do të rikthehen nëse Qeveria e Kosovës nuk e themelon Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe nuk e tërheq vendimin për reregjistrimin e makinave.



Kurti takon Borrellin, diskutojnë për ecurinë e dialogut

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili po qëndron në Francë dhe po merr pjesë në Forumin e Paqes në Paris, para fillimit të forumit, është takuar me përfaqësuesin e lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Josep Borrell dhe me përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak.

Dinamizimi i dialogut Kosovë - Serbi, zbatimi i vendimit për targarat ilegale, zhvillimet e fundit në Kosovë dhe çështjet e tjera aktuale ishin temat qendrore të takimit. Në këtë takim

kanë marrë pjesë edhe zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Kreshnik Ahmeti dhe këshilltarët e kryeministrit, Jeton Zulfaj dhe Fisnik Korenica.

Kryeministri Kurti ka theksuar elementët e kornizës së marrëveshjes për normalizimin e plotë të raporteve me njohjen reciproke në qendër, ndërsa ka thënë se propozimi franko-gjerman, që ka mbështetur Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian, i paraqitur nga emisarët Jens Plotner dhe Emmanuel Bonne, shërben si bazë e mirë për diskutime të mëtejshme.

Duke biseduar për zhvillimet e fundit në veri të vendit, kryeministri Kurti ka ritheksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vendosmërinë për sundimin e ligjit dhe përkushtimin për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend.

Zogaj për parkingun nëntokësor në Prishtinë: Do të hapet në fund të këtij muaji

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Në fund të muajit nëntor pritet të bëhet hapja zyrtare e parkingut nëntokësor i cili gjendet te Fakulteti Filologjik në Prishtinë. Lajmin për "Telegraf"-in e ka bërë me dije nënkryetari i komunës së Prishtinës, Alban Zogaj. "Po, do të bëhet hapja zyrtare e parkingut nëntokësor, por në fund të muajit", ka thënë Zogaj.

Për këtë parking ka pasur reagime nga qytetarët e Prishtinës dhe nga shoqëria civile për çmimet e larta. Por, nga komuna e Prishtinës janë arsyetuar se në këtë projekt kanë të bëjnë me partneritet publiko-privat dhe se komuna nuk është pronare e plotë e parkingut. Sipas tyre, përcaktimi i tarifave të parkimit është

bërë në bazë të çmimit të tregut dhe duke marrë parasysh "investimet e larta të koncesionarit në ofrimin e sigurisë së lartë dhe kushteve shumë më të favorshme krahasuar me parkingjet e tjera me këto çmime. Duam t'ju rikujtojmë, se në parkingjet të cilat janë pronë e NP 'Prishtina Parking', rrjedhimisht komunës së Prishtinës, çmimet për parking janë shumë më të lira. Mirëpo, në rastin e Parkingut Nëntokësor, kemi të bëjmë me partneritet publiko-privat, ku komuna nuk është pronare e plotë e parkingut", thuhet në komunikatën e komunës së Prishtinës.

Kundër çmimoreve së parkingut është edhe Lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë.



PARKING NËNTOKËSOR

- Përlongje nëntokësore të mësueshme për të gjitha banorët e kompleksit
- Do të jetë ure lidhëse për të gjitha blloqet
- Qasje të lehtë dhe siguri maksimale
- Me të gjitha elementet përçelëse, sipas standardeve Europiane



KMShK-ja organizoi tryezë diskutimi me gazetarët e Anamoravës

GJILAN, 11 NËNTOR - Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMShK), në bashkëpunim me Klubin e Gazetarëve "Beqir Musliu", ka organizuar një tryezë diskutimi me gazetarët të rajonit të Anamoravës, gjatë së cilës është biseduar për problemet me të cilat ballafaqohen mediet online.

Musa Sabedini, kryetar i Klubit të Gazetarëve "Beqir Musliu" dhe anëtar i Kuvendit të KMShK-së, ka folur për sfidat gjatë punës së përditshme në mediet online në këtë rajon.

Ai ka theksuar se një ndër problemet kryesore është publikimi i lajmeve të rrejshme nga grupe të caktuara në rrjetet sociale, që po e dëmtojnë gazetarinë e mirëfilltë.

Imer Mushkolaj, drejtor ekzekutiv i KMShK-së, ka folur mbi zhvillimet e

fundit në konceptin e vetërregullimit dhe kodin e etikës.

Muhamet Halimi nga 2LONLINE.com ka sjellë në vëmendje problemet financiare me të cilat përballen mediet në Gjilan, kurse Heset Zymberi nga Gjilani.info ka folur për rëndësinë e medieve lokale online në funksion të informimit më të mirë të publikut.

Si shqetësim është përmendur edhe mosrespektimi i të drejtës autoriale nga mediet.

Kontribut në debat kanë dhënë edhe Enver Sadiku nga Kryelajmi.com e Rexhep Hasani nga Dardanapress.info. Pjesë e tryezës ishin edhe veteranët e gazetarisë, Nexhmedin Ymeri e Xhevat Pira.

Aktiviteti është mbështetur nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë.

Malisheva shpall "Qytetar Nderi" tri personalitete

Malishevë, 11 nëntor - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka njoftuar se Asambleja Komunale ka marrë vendim që t'i shpallë "Qytetar Nderi" të komunës së Malishevës tri personalitete që, me veprimtarinë e tyre dhe të familjeve të tyre, sipas tij, sot krenohet gjithë shqiptaria. "Qytetar Nderi" i komunës së Malishevës janë shpallur këto personalitete: Xhemal Jashari, vëllai i dëshmorit të kombit Ismet Jashari - komandant 'Kumanova', një ndër luftëtarët dhe komandantët më emblemantikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që asokohe ishte bërë burim frymëzimi për luftëtarët e lirisë në mbarë Kosovën; Skënder Sinani, vëllai i dëshmorit të kombit Tahir Sinani, ku me

veprimtarinë dhe heroizmin e tij dhe gjithë familjes së tij sot ndihemi krenarë të gjithë ne, gjithë Malisheva, gjithë Kosova dhe gjithë Shqiptaria; Shpëtim Idrizi, deputet në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë, i cili mbrojtë luftën e UÇK-së në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si dhe bëri organizime brenda dhe jashtë Shqipërisë për promovimin dhe zgjidhjen e çështjes çame", ka thënë Kastrati. Ai ka bërë me dije se ceremonia solemne e dhënies së çmimit "Qytetar Nderi" i komunës së Malishevës për këto personalitete të nderuara do të bëhet në seancën solemne që komuna e Malishevës do ta mbajë me rastin e shënimit të festave të nëntorit.



Prokuroria Themelore në Gjakovë ngreh 20 aktakuza për dhunë në familje

GJAKOVË, 11 NËNTOR - Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë muajit tetor 2022 ka ngritur 20 aktakuza kundër 20 personave për

veprën penale "Dhuna në familje".

Prokuroria Themelore në Gjakovë mbetet e përkushtuar për luftimin e

kriminalitetit, ngritjes së efikasitetit në punë, transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu, kjo prokurori

është e angazhuar që të kryejë me seriozitet të lartë të gjitha rastet, me prioritet të veçantë ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje.



Ambasadori francez: I përkrahim vizat, por ka ca çështje për t'u diskutuar

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka thënë se Franca e mbështet plotësisht liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, megjithatë ka theksuar se janë disa çështje që janë duke u diskutuar në nivel teknik në BE. "Në qershor të këtij viti, presidenti Emmanuel Macron i ka thënë presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, se ne jemi në favor të liberalizimit të vizave me disa

masa përcjellëse që duhet të realizohen. Diskutimet teknike për liberalizimin e vizave po vazhdojnë dhe po presim që të ketë një vendim pozitiv, të favorshëm", ka deklaruar ambasadori francez, Guerot. Të enjten vendet anëtare të BE-së në takimin e grupit punues për vizat kanë përafuar qëndrimet rreth një kompromisi, sipas të cilit, do të miratohej vendimi për liberalizimin e vizave për

Kosovën, që do të hynte në fuqi më 1 nëntor 2023, kur do të nisë zbatimi edhe i sistemit evropian të informimit dhe autorizimit të udhëtimit (ETIAS). Këto komente Guerot i bëri pas një ceremonie të organizuar bashkërisht në mes të Ambasadës së Gjermanisë dhe Ambasadës së Francës në përkujtim të armëpushimit të 11 nëntorit 1918, veprim ky që i dha fund Luftës së Parë Botërore.



Abazi: Qeveria, qasje të gabuar për kërkesat e ndërkombëtarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës, njëherësh deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, përmes një konference për medie mbajtur të premten, ka kritikuar qeverinë që, sipas tij, ka injoruar iniciativat për të ndihmuar në procesin e dialogut si dhe në politikë të jashtme. Abazi ka thënë se janë

prekur raportet e Kosovës me partnerët, në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke iu referuar vendimit për targa, Abazi ka thënë se kjo çështje do të mund të priste deri në momentin e nënshkrimit të një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Largimi i serbëve nga institucionet e Kosovës është karta dhe çelësi për Serbinë për ta rrezuar nivelin e zbatueshmërisë së marrëveshjeve të Berlinit si dhe

për ta mbajtur minimumin e presionit ndërkombëtar për mosvendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë", ka thënë Abazi. Ai ka thënë se kërkesat e ndërkombëtarëve do të duhej të konsideroheshin si dhe ka përkrahur idenë që Kosova t'i fillojë konsultat rreth themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Duke komentuar çështjen e Asociacionit, Abazi ka theksuar se ai nuk duhet të ketë asnjë

kompetencë ekzekutive porse meqë ekziston një mendim i Gjykatës Kushtetuese, konform tij Kosova duhet ta bëjë hapin e parë. Abazi ka thënë se deri tek ashpërsimi i raporteve të Kosovës ka ardhur për shkak të qasjes së gabuar në procesin e dialogut si dhe politikës së jashtme. "Është urgjente që t'i kthehemi tavolinës së dizajnit të politikës së jashtme dhe qëndrimeve të analizuar mirë për t'i rikthyer

marrëdhëniet dhe për t'i arritur objektivat tona në interes të shtetit dhe publikut", ka thënë Abazi. Abazi ka shtuar se qeveria, përfshirë kryeministrin Albin Kurti, ka refuzuar që ai të ndihmonte në hartimin një strategjie më të fuqishme gjatë vizitës së tij në ShBA, vizitë kjo që u realizua muajin maj. Mes të tjerash, Abazi ka kritikuar edhe qasjen e qeverisë në raport me krizën energjetike.

Presidentja i thërret në takim partitë për caktimin e datës së zgjedhjeve në veri

Prishtinë, 11 nëntor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka ftuar në takim për 14 nëntor subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për caktimin e datës së zgjedhjeve të parakohshme për kryetarë të katër komunave në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan.

Kryetarët e këtyre komunave të banuara me shumicë serbe kanë dhënë dorëheqje më 5

nëntor në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Në njoftimin e presidencës, më 11 nëntor, thuhet se, pas konsultimit me partitë politike, Osmani pritet ta shpallë datën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme Ligji për zgjedhjet lokale në Kosovë thotë se "pas shpërbërjes së Kuvendit të

Komunës, ose shkarkimit të kryetarit të Kuvendit Komunal, nëse nuk parashtrohet ankesë në afat prej pesë ditësh të Gjykata Kushtetuese, zgjedhjet e parakohshme lokale shpallen nga presidenti i Kosovës". Zgjedhjet, sipas ligjit, shpallen jo më vonë se dhjetë ditë pas shpërbërjes së kuvendeve komunale, ndërsa duhet të mbahen më herët se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërbërjes së tyre.



INTERVISTA E MUHAMET MAVRAJ NË EDICIONIN SPECIAL TË KLAN KOSOVËS MË 8 NËNTOR 2022

Me këtë Qeveri katastrofë brenda e katastrofë jashtë! Plani rus i zvarritjes së Kosovës po funksionon!

Me realitetin e ri s'do të ketë njohje as të ndërsjellë Kosovë-Serbi dhe as njohje të njëanshme, as në qendër, as në periferi dhe as në margjinat



Në Serbi e Mal të Zi nuk kam shkuar dhe nuk shkoj, sepse e di që më arrestojnë



(PRISHTINË, 8 NËNTOR 2022)

Edicioni Special: Për takimin e kryeministrit Albin Kurti me liderët opozitarë, por edhe për çështjet tjera që ndërlidhen me situatën e fundit në veri të Kosovës dhe çështje të tjera në këtë intervistë do të flasim me publicistin Muhamet Mavraj. Z. Mavraj, mirë se keni ardhur në studion e Klan Kosovës...

Mavraj: Mirë se ju gjeta! Faleminderit shumë, Shkodran!

Edicioni Special: Besoj që e keni analizuar, ndoshta nga ajo fotografia dhe imazhi që është shfaqur fillimisht në rrjetet sociale, më pas edhe në mediumet e mëdha, ajo fotografia... ku kryeministri në ballë (majtas) dhe në krah kishte Xhelal Sveçlën (djathtas), ministrin e brendshëm, e më pas vinin liderët e subjekteve opozitare. Është komentuar shumë se renditja ndoshta nuk ishte e mirë dhe ishte një lloj përçmimi për spektrin opozitar,

duke mos i vendosur përballë, ku ishin vendosur anash, ku në fron ishin kryeministri dhe ministri, dhe më pas vinin liderët opozitarë. E keni parë ju këtë kështu apo thjesht ishte ndoshta renditje e rastit?

Qeveri sobiste

Mavraj: Në fakt, kur dëgjova që zotëri Haradinaj e ka lëshuar takimin, mendova që e ka bërë pikërisht për shkak të asaj renditjeje që unë e pashë në foto. Është e pazakontë si renditje e tillë. Meshkujt e shtëpisë ulën pas dere ose në krahun e të zotit të shtëpisë. Në pikëpamje protokollare këta kanë bërë shpesh gabime, edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme edhe në kryeministri e kështu më radhë. Ndodh që në atë dijeninë e tyre gjennale kjo është krejt në rregull, por mua nuk më është dukur aspak në rregull. Aty ku ishte i ulur ministri i policisë do të duhej të ishte kryemysafiri ose për shkak

se askush më askënd nuk është mirë do të duhej të gjendej një formulë tjetër ku askush nuk ndihet i nënçmuar në atë lloj tryeze.

Edicioni Special: Ose më i moshuari?

Mavraj: Ose më i moshuari ose ai për të cilin merren vesh vetë mysafirët, por zakonisht aplikohet një formulë që nuk e ofendon askënd.

Edicioni Special: Nga këndvështrimi juaj, meqë e njihni Albin Kurtin para të gjithë neve dhe e keni njohur edhe nga afër, a mund të jetë bërë kjo qëllimisht, pra për të treguar se Albin Kurti është i pari, më pas vjen Xhelal Sveçla dhe të tjerët në rang apo vërtet është gabim protokollar?

Mavraj: Nuk e përjashtoj mundësinë që është bërë qëllimisht për shkak se një sens snobizmi për shumë vite i përshkon të gjithë këta, edhe përpara se këta të jenë në

-Çintegrimi i serbëve hedh në ujë tërë përpjekjet 22 vjeçare për integrimin e tyre në sistemin e Kosovës dhe njohjen e Kosovës si shtet të tyre;

-Kurti duhej të mësonte nga gabimet e Ramushit

- Po të investohej në përçarjen e deputetëve serbë sa është investuar ta zëmë për përçarjen e profesorëve, arsimtarëve dhe shtresave të tjera të shoqërisë sonë, ne, të paktën, tani do t'i kishim tre deputetë serbë në anën tonë, mjaftueshëm sa për të ta ndryshuar Kushtetutën e Kosovës.

institucionet e Kosovës, shumë përpara se të jetë kryeministër ky dhe edhe gjatë këtyre tri viteve që është paraqitur. Por, sidoqoftë, qoftë e pamenduar apo e menduar diçka e tillë është gabim dhe nuk duhet të përsëritet më.

Tani ndërrojnë pozicionet

Edicioni Special: Mirë! Për të iu kthyer temës kryesore se për çfarë i ftoi kryeministri Kurti liderët e opozitës,... situatës së krijuar pas largimit të deputetëve serbë, policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve. Si po e shihni ju gjithë këtë situatë?

Mavraj: Situata është më e komplikuar që nga paslufta, në rrafshin politik dhe të raporteve ndëretnike këtu në Kosovë. Mendoj se këtu kemi ardhur për shkak të një liste të terë të arsyeve, por ajo që është përmbledhje e të gjithave, me këtë lloj tërheqje është rritur gjithçka që është ndërtuar që

nga koha e UNMIK-ut e deri më sot për integrimin e serbëve në institucionet e Kosovës, ashtu që ata të ndiheshin si pjesëtarë të barabartë të këtij shteti me të tjerët dhe në thelb ta njihnin shtetin e Kosovës. Me qëllim apo pa qëllim kjo situatë është e re, i ndërron pozicionet, sigurisht se i ndërron edhe fuqitë politike të palëve të përfshira në këtë tension shumë serioz. Dhe, ajo që ka përfituar deri këtu më së shumti është Serbia që sigurisht do të jetë në një pozicion shumë më të favorshëm para bashkësisë ndërkombëtare dhe do të fuqizohet më shumë roli i saj në tryezën e bisedimeve dhe gjithsesi do të jetë më pak se gjithmonë e gatshme të bëjë çfarëdo lëshimi për Kosovën.

Edicioni Special: A ia ka vlejtur, z. Mavraj, një çështje e tillë, pra që Kosova t'i largojë rreth mbi 600 policë, gjithë ata prokurorë e gjyqtarë për ta çuar përpara një vendim siç është ai targave, pra

për t'i çuar përpara siç po thuhet këto "qortimet" (ndaj ngasësve të makinave me targa të vjetra) të cilat janë fillimisht... meqenëse zyrtarët e qeverisë dhe të pushtetit janë duke thënë se përfundimisht po tregohet se këtu ka shtet dhe se vendimet duhet të zbatohen nga të gjithë...

A ia ka vlejtur, siç thatë edhe ju, që gjithë ai progres për t'i integruar serbët që nga paslufta e deri më tani, të vijmë këtu ku në njëfarë forme ka rënë poshtë?

Mavraj: Absolutisht nuk ia ka vlejtur dhe ka qenë gabim që nga nisja, vjet apo parvjet, e policisë speciale në veriun e Kosovës ku praktikisht policia jonë ishte izoluar tërësisht. Njëri ministër dërgonte policinë speciale në veri dhe përkaj tij një ministër tjetër i qeverisë së Kosovës i bllokonte rrugët sikur të ishin të koordinuar si është më së miri mes vete. Të jemi të qartë, serbët e Kosovës e kanë ndezur luftën në ish-Jugosllavi, faktikisht. Serbët e Kosovës për fatin e keq të tyre, por edhe të popujve të tjerë janë përdorur si instrument për qërimin e hesapeve të Serbisë me të tjerët përreth vetes. Edhe kësaj radhe, ndonëse kanë dalë shumë të humbur nga lufta e Kosovës, edhe kësaj radhe, janë duke u përdorur pothuajse njëjtë, pa kurrfarë ndjeshmëri njerëzore të Beogradit ndaj tyre. Ata janë në një pozicion shumë më ta palakmueshëm sesa në kohën e Millosheviqit. Pse? Sepse veçse e kanë përjetuar një humbje dhe humbjen e dytë e ndiejnë. Unë e ndjej thellësisht se pa

vullnetin e tyre janë duke u përdorur, pa vullnetin e tyre janë duke e lëshuar policinë, gjykatat dhe institucionet tjera shtetërore të Kosovës e kështu me radhë, por ja që kjo është duke ndodhur dhe asnjëherë më përpara serbët kaq unikë nuk kanë qenë. Po të investohej në përçarjen e tyre sa është investuar ta zëmë për përçarjen e profesorëve, arsimtarëve dhe shtresave të tjera të shoqërisë sonë e kështu me radhë, ne, të paktën, tani do t'i kishim tre deputetë serbë në anën tonë, mjaftueshëm sa për të ta ndryshuar Kushtetutën e Kosovës.

Çdo lëshim është bërë për shkak të vetos ruse

Edicioni Special: Ndërkohë, z. Mavraj, a nuk është mjaft tani? Jemi në vitin 2022 dhe ende, ta quaj, kushtimisht, jemi duke i marrë me të mirë, duke i lutur serbët në veri... Ata janë brenda territorit të Republikës së Kosovës. A nuk është bërë mjaft për shtetin që të vendosë kufi diku?

Mavraj: Gjithmonë ka qenë mjaft! Edhe përpara se ata të përdorehin nga Millosheviqi. Gjithmonë ka qenë mjaft! Edhe atëherë këtu ka qenë Kosovë. Por, janë tri Rusi, një e madhe dhe dy të vogla: Bjellorusia dhe Serbia e cila për fatin tonë të keq është fqinji ynë dhe nuk kemi ku ta çojmë, sepse është aty. Dhe e tërë kjo që po bëhet, të gjitha këto lutje apo të ashtuquajtura lutje e kështu me radhë po bëhen për shkak të

vetos ruse në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Për shkak të asaj vetoje e kemi ende, të paktën formalisht në fuqi, Rezolutën 1244. Për shkak të vetos ruse nuk është njohur pavarësia e Kosovës menjëherë në vitin 1999. Për shkak të vetos ruse as EULEX-i nuk ka mundur të vijë ashtu siç ka qenë e paraparë. Për shkak të vetos ruse nuk ka as anëtarësim të Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe për rrjedhojë në dhjetëra organizata tjera ndërkombëtare. Kështu që... ky është realiteti. I lusim ne për të mirën e tyre apo për të mirën tonë apo për të mirën e dyanshme, realiteti është ky...

Edicioni Special: ...Rusia ka vazhduar dhe është duke e përdorur veton. Nuk është se ka ndryshuar situata se Kosova po i trajton në këtë mënyrë tektonet e Serbisë në Kosovë...

Mavraj: Po. Rusia e ka përdorur dhe do ta përdorë kudo që mundet veton kundër Kosovës, jo pse e don Serbinë, por sepse ka interesat e veta. Por, Kosova shumë shpesh ka ditur që një veto të padukshme t'ia aplikojë vetvetes. Të jemi të qartë, që nga viti 2014 është frenuar gjithçka në prestigjin ndërkombëtar të Kosovës, pothuajse, veçanërisht nga viti 2017 e deri më sot. S'ke për tri vjet nga kjo qeveri... nuk ke asnjë njohje ndërkombëtare. S'ke për tri vjet asnjë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Tani me realitetin e ri s'do të ketë njohje as të ndërsjellë Kosovë-Serbi

dhe as njohje të njëanshme, as në qendër, as në periferi dhe as në margjinat e çfarëdo plani...

Pa e bombarduar edhe një herë Serbia nuk na e jep njohjen de-jure


Edicioni Special: ... a keni besuar se do të ketë një njohje të ndërsjellë edhe nëse nuk do të ishte kështu situata siç është tani?

Mavraj: Në asnjë mënyrë! Njohje de-jure në asnjë mënyrë! E shumta që do ta bënte Serbia, por me një presion të fuqishëm ndërkombëtar dhe pa këto ledhatimet evropiane, ka mundur të pritej njohja de-facto që është njohje e përkohshme dhe që mund të tërhiqet në çdo kohë. Njohjen de-jure, jo, për shkak se Serbia është në ndikimin e fortë të Kishës dhe nën pushimin rus në institucionet kryesore të Serbisë, më i rëndësishmi, shërbimi i tyre sekret, me ardhjen e këtij zotëri Vulinit në krye të tij, që është një fashist i vërtetë, dhe rezultati i parë, konkret, është ky që jemi duke e parë sot dhe tani këtu. Ka shumë faje të rënda Evropa në raport me Rusinë dhe në raport me Serbinë. Pa një presion të fortë, ndoshta pa bombardimin e dytë, Serbia njohje de-jure nuk do të na jepte. Ata po shpresojnë se pasi që 500 vjet nën Turqi kanë pritur dhe janë kthyer në Kosovë, edhe këta (perëndimorët) do të shkojnë, qoftë me fajin e shqiptarëve,

qoftë me ndonjë shpikje tjetër dhe këtu do të kthehet Serbia, ose së paku atje ku është kisha e vërtetë e tyre, veriu i Kosovës, të ndahet. Mos të harrojmë, shumë retorikë boshe është shpërndarë në ajrin e Kosovës për konceptin e reciprocitetit. Ku është tani reciprociteti? Përse të njëjtën nuk janë duke e bërë shqiptarët në Serbi, në Preshevë, Bujanoc, Medvegjë, e gjetiu? Ku është reciprociteti që proklamohet këtu?

Edicioni Special: Çfarë lloj reciprociteti jeni duke menduar kur po thoni do të duhej të ndodhe ose pse nuk janë duke e bërë, pra ngjashëm edhe ata të kërkojnë më shumë dhe në njëfarë forme të jenë destruktivë siç është pjesa veriore e Kosovës...?

Mavraj: Kur e proklamoni atë koncept, ti e parasheh edhe një plan "B" edhe një plan "C" edhe një plan "D". Unë nuk e di a e kanë paraparë këta këtë gjendjen e re e cila tani është këtu, por e di se gjithçka është duke çuar ujë në strategjinë ruse për zvarritjen sa më shumë për çfarëdo arsyeje të çështjes së Kosovës. Serbët janë në ekspansion tensionues në Mal të Zi, në Kosovë, në Bosnje dhe kanë një fashizëm kurrë ma të lartë sesa edhe në kohën e luftës në Serbi. Pothuajse sot asnjë medium, nga mijëra medime të Serbisë nuk e përdorë termin "albanci". Të gjithë na fyejnë, na ofendojnë, aty është terë bota dhe askush nuk reagon asnjëherë, as qeveria jonë...



Mavraj: Të jemi të qartë, që nga viti 2014 është frenuar gjithçka në prestigjin ndërkombëtar të Kosovës, pothuajse, veçanërisht nga viti 2017 e deri më sot. S'ke për tri vjet nga kjo qeveri... nuk ke asnjë njohje ndërkombëtare. S'ke për tri vjet asnjë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Tani me realitetin e ri s'do të ketë njohje as të ndërsjellë Kosovë-Serbi dhe as njohje të njëanshme, as në qendër, as në periferi dhe as në margjinat e çfarëdo plani...



Edicioni Special: A e di qeveria jonë për këto politika të Serbisë? Në fakt të njoftuar janë siç është i njoftuar i gjithë kombi shqiptar, por sa kanë ndërmarrë veprime për t'i dalë në ballë këtyre çështjeve?

Mavraj: Asnjë fare, asnjë fare. Qeveria jonë nga kriza në krizë. Dhe këtë model të prodhimit të krizave e njih Kosova, i njeh modelet e liderëve të mëparshëm të Ballkanit...

Edicioni Special: Prej padijenisë apo e rastësisë...

Mavraj: Unë nuk besoj se është thjesht padijeni, sepse nga kriza në krizë....

Arratisjet dramatike nga Kosova

Edicioni Special: Pse do t'i konvenonte një situatë në dëm të saj?

Mavraj: Atë do ta shohim në të ardhmen, por ajo që di unë, në planin e brendshëm është situatë katastrofike. Kur një biznes 100-vjeçar, si për shembull ta zëmë kuzhinën popullore "Opoja", e cila thotë se do ta shesim biznesin dhe do të ikim nga këtu sepse fëmijët nuk janë duke ndier siguri për të ardhmen; Kur një kandidat për doktor shkence, punon berber, i cili me qethi sonte, ka dy binjakë dhe po i pret dy të tjerë, thotë se për herë të parë ka filluar të mendojë nën ethe për të ardhmen e fëmijëve të tij, e ai është një djalë shumë i talentuar dhe i lidhur me vendin... Në kolegjin ku unë punoj, në AAB, i cili është ndër më të organizuarit në Kosovë

dhe ka shumë studentë, atë që e kam parë dy ditë pas fillimit të luftës në Ukrainë më 26 shkurt ka qenë shokuese, e kam fjalën për praninë e studentëve në provim. Nga 67 studentë vetëm shtatë djem, dhe ai nuk është profil i vajzave, është profil i përzier - Administratë Publike. Nga 85 të nesërmen, vetëm 19 djem, krejt tjerat vajza. Pastaj nga 32 studentë në prill vetëm katër djem, pastaj nga 15 studentë në qershor, vetëm dy djem dhe nga pesë veta në shtator, vetëm një djalë...

Edicioni Special: Çfarë po i bie kjo z. Mavraj?

Mavraj: Kjo i bie që, kur folëm në planin e brendshëm, është një arratisje masive e heshtur e rinisë...

Edicioni Special: Po pse vetëm djemtë e braktisin vendin?

Mavraj: Po, sepse ata janë fuqi fuqi punëtore dhe ata po na marrin djemtë për mungesat e tyre në perëndim.

Edicioni Special: A mund të ketë ndodhur diçka tjetër, ndoshta nuk kanë dalë jashtë vendit?

Mavraj: Jo, nuk është e vërtetë. Ata kanë dalë jashtë vendi dhe me cilimndo që takohesh sot, prandaj i kam rralluar postimet sepse nuk po kam asgjë të mirë të them dhe nuk dua që të tjerët të dekurajohen, ... me secilin që takohesh regjistrohet vetëm sa për ta marrë një vërtetim dhe për t'u larguar.

Edicioni Special: Kush është fajtor për këtë?

Mavraj: E terë politika jonë, të

gjithë ne bashkë. Nuk ka një fajtor të vetëm, por shpresat e tyre të kota kanë qenë sidomos në këtë qeveri.

Edicioni Special: Për këtë është thënë se do të jetë qeveri e shpresës...

Mavraj: E shpresës!

Edicioni Special: A është qeveri e shpresës?

Mavraj: Jo. Doli diçka komplet tjetër!

Edicioni Special: Pse jo?

Mavraj: Arsyet janë të shumta, por kjo lloj ideologjie, ky lloj modeli i qeverisjes, me këtë helmim që ia ka bërë shoqërisë kosovare, shoqërisë shqiptare në përgjithësi, ku në Kosovë njerëzit që janë të punësuar dhe me pagë të mirë është shumë vështirë t'i ndalësh, për fat të keq gjithnjë e më shumë...

Edicioni Special: ...Ndoshta një trend i tillë është në krejt Ballkanin, jo vetëm në Kosovë...

Mavraj: Nëse duam të arsyetohemi po. Ka edhe vende të tjera, ka edhe brenda Bashkimit Evropian (BE) që lëvizin, por kërkesat këtu kanë qenë modeste, për një punë mesatare, për një rrogë mesatare për t'u ndarë të kënaqur... S'ka investime. Përmendet fjala luftë, të ikin 10 mijë veta. Përmendet fjala konflikt, të ikin 10 mijë veta. Përmendet fjala thyerja e traktatit me Serbinë, të ikin 10 mijë veta. S'ka as program...

Edicioni Special: Mendoni se kryeministri Kurti i ka paraprirë

kësaj sepse disa herë në media ndërkombëtare ka përmendur fjalën luftë...

Mavraj: Shpresat kanë qenë ideale tek ai. U habitsha me njerëzit!

Edicioni Special: Kur thoni "sa herë përmendet fjala luftë, ikin 10 mijë veta"... Në fakt ka qenë kryeministri Kurti që në disa intervista ka përmendur fjalën luftë ose mundësinë e luftës me Serbinë...

Mavraj: Po. Ka qenë shumë i pamatur me ato deklarata.

Edicioni Special: I pamatur apo mendoni se kanë qenë të orkestruara?

Mavraj: Unë nuk e di tash se kush çfarë ka në kokë. Është shumë e vështirë që unë të jem shumë i saktë, me ditë mirë, se çfarë ka në kokë ai, sepse nuk kam asnjë lloj komunikimi më të, që të jemi i sigurtë deri në fund, por e di që ka qenë e gabuar dhe di se ai premtimi që është dhënë më 3 ose 4 tetor 2019, se më 6 tetor 2019 do të lind dielli që kurrë më nuk do të perëndojë në Kosovë është: premtim për përralla! Po e shohim çfarë po ndodh.

Këta (pushtetarët e Kosovës) nuk janë zyrtarisht zëdhënës të Serbisë

Edicioni Special: Për të iu kthyer shkurt planit franko-gjerman. E pamë sonte... Glauk Konjufca në "Rubikon" të "Klan Kosovës" e pranoi se në një farë forme mbase është një plan i mirë. Më mirë me të se pa të. Keni kuptuar

ju diçka nga ky plan meqenëse deri tani e konfirmon edhe z.Konjufca se kanë qenë pikërisht liderët dhe mediat serbe që kanë filluar të tregojnë detaje dhe me pas tash zyrtarët qeveritarë janë duke filluar gradualisht të japin ndonjë informacion, sepse deri më tani ka qenë pa informacione...

Mavraj: Në linja kryesore, në linja të trasha të gjithë dimë ngapak. Kosova as nuk e ka pranuar qartësisht dhe as nuk e ka refuzuar qartësisht. As Serbia nuk e ka pranuar qartësisht, as nuk e ka refuzuar qartësisht. Ne do të duhej të dinim më shumë sepse në fund të fundit nuk ka çfarë të fshehet këtu. Kot dikush pretendon ta monopolizojë ose me mbajt në grusht një plan, i cili gjoja ka një plan magjik. Ne e dimë pak a shumë çfarë ka. Në ato vijat e trasha që unë i njoh, Serbia nuk humb asnjë gjë fare, vetëm se merr pamëritueshëm, pakufi, shumë, shumë, shumë fuqi dhe shumë ndihma. Asnjë gjë nuk jep.

Edicioni Special: Merr prej planit franko-gjerman?

Mavraj: Patjetër!

Edicioni Special: Çfarë merr?

Mavraj: Kosovës i jepet anëtarësimi në NATO që është thjesht premtim, duke i eliminuar ato katër shtetet e BE-së, NATO-s, që njëkohësisht janë edhe të BE-së, me njohje të heshtur ose me njohje të deklaruar të tyre sikurse shtetet tjera... sepse janë pesë shtete, ku katër prej tyre janë në NATO. Asnjë gjë nuk jep Serbia. Serbia përfiton... oreksi rritet duke ngrënë.

Edicioni Special: Çfarë konkretisht sipas këtij plani, sipas jush fiton Serbia?

Mavraj: Perspektiv evropiane. Anëtarësim të përsheptuar dhe një pako të fortë ekonomike.

Edicioni Special: Por e refuzoi?
Mavraj: Kush tha?

Edicioni Special: Kryeministri dhe kryekuqendari...

Mavraj: (Qesh). Këta nuk janë zyrtarisht zëdhënës të Qeverisë së Serbisë. Këta po tregojnë, ne ende nuk i kemi dëgjuar vetë ata.

Edicioni Special: Kryeministri Albin Kurti në fakt ka thënë se Serbia e ka refuzuar planin franko-gjerman dhe prandaj po i bën të gjitha trazirat në veri dhe po e krijon këtë situatë për shkak të refuzimit të planit...

Mavraj: Nuk e di se në cilën cilësi ka folur. Ne nuk i kemi parë ato dhe nuk mund të bazohemi në këto deklarata.

Edicioni Special: Në cilësinë e kryeministrit.

Mavraj: Këta janë ta pasaktë vetë. Kryetarja thotë kjo është "fake news", ky tjetri thotë diçka tjetër, ai tjetri thotë diçka tjetër varësisht prej lëvizjeve ditore. Por është e qartë, është e qartë se është zbutur pak retorika e tyre, pas këtyre zhvillimeve atje në veri. Taktikisht është e mençur të thuhet se e pranojmë, nëse je i sigurt se ata e kanë vërtet e kanë refuzuar.

Edicioni Special: Edhe nëse e pranon tash, meqenëse ju keni dyshime se Serbia ende nuk e ka refuzuar...

Mavraj: Nuk është tani kjo ajo situata kur dikush që refuzon planin do të bombardohet. Kjo është një situatë krejtësisht tjetër. Nuk është as serioze.

Edicioni Special: ... por nëse edhe Serbia e pranon meqenëse keni rezerva se mund ta ketë refuzuar, pra nëse e pranon çfarë do të thotë kjo?

Mavraj: Nëse Serbia e pranon ajo do të jetë qysh tash në avantazh sepse do t'i kërkohet rol për kthimin e serbëve në institucionet tona dhe këtu do të ketë probleme shumë serioze pastaj.

Edicioni Special: A duhet të pranohen ata, lind pyetja që kanë hequr uniformat?

Mavraj: S'mund të pranohen, sepse kanë shkuar. Duhet zgjedhje të reja, duhet përtëritja e mandateve në Kuvendin e Kosovës dhe nuk do të bëhet. Ata do të shatazhojnë dhe do të zvarrisin pafundësisht shumë, njëjtë si qeveria jonë pafundësisht shumë me turlifare arsye për ta përmbushur modelin e

zvarritjes se çështjes së Kosovës.

Edicioni Special: A e shihni Kurtin si kryeministër që do ta nënshkruan marrëveshjen?

Mavraj: Me kë? Çfarë do të nënshkruajë? Tani është pozicioni i ri. Nesër mund të jetë shumë më i ri dhe shumë më tjetër. Situata shumë më tjetër. Ku po shkojnë këta policë që po çarmatosën? Po i dorëzojnë uniformat tona, armët tona, gjithçka që kanë tonën, gradat tona, gjithçka. Por, ku po shkojnë pastaj ata? A po merret dikush me këtë pjesë? Ne nuk kemi asnjë lloj pranë, fare hiç në rrugët e qyteteve në veri...

Edicioni Special: Ministri i Brendshëm po thotë se Policia e



Kosovës ka kapacitete për ta menaxhuar situatën dhe është e pranishme në veri... Është bërë zëvendësimi i tyre duke u marrë nga rajonet tjera.

Mavraj: Ky ka qenë momenti që ne me mençuri tani ta kishim FSK-në në veri, pa protestat e serbëve dhe jo të vinim në një situatë ku të gjithë ata njerëz i braktisin uniformat tona dhe e ke një përforsin të rolit të EULEX-it, merre me mend, misioni i BE-së dhe sigurisht edhe të NATO-s. Jemi shumë prapa. Jemi kthyer shumë prapa.

Edicioni Special: Jemi kthyer prapa?

Mavraj: Shumë prapa.

Edicioni Special: A po dëshiron dikush ta kthejë në pikën zero procesin?

Mavraj: Patjetër! Aq më mirë për ta. Plani serb dhe rus po funksionon shumë mirë.

Edicioni Special: Për ta, mirë me u kthyer në pikën zero?

Mavraj: Për ta është më mirë me u kthyer në pikën zero sepse do të kërkohet më shumë dhe do ta marrin.

Edicioni Special: Çka nëse nuk marrin... sepse së paku prej disa politikëbërësve dhe analistëve, kryeministri po tregohet këmbëngulës, mos ta quaj

kryeneç, në raport me Serbinë. Çfarë nëse është më kërkues?

Mavraj: Kanë ndryshuar gjërat në këto dy ditë, komplet...

Edicioni Special: Kanë ndryshuar gjërat, për kë?

Mavraj: Për Kosovën, për Serbinë, për Evropën, për Escobarin, për këtë Lajçakun që është krejtësisht proserb...

Kurti duhej të mësonte nga gabimet e Ramushit

Edicioni Special: A besoni se do të tërhiqet kryeministri, meqë po thoni se kanë ndryshuar gjërat?

Mavraj: Nuk është dashur. Nga përvoja që kemi pasur me taksën që është qitur atëherë,

njëanshëm dhe pa koordinim me miqtë e vërtetë të Kosovës, në plan të parë këtu po flas për amerikanët, nga ajo përvojë është dashur të mësojë edhe ky (Kurti). Dhe ato që ia ka thënë Ramushi, nëse janë të sakta...

Edicioni Special: ...që po na dëmton neve, Kosovën, dhe veten...

Mavraj: ...nëse janë të sakta, vërtet qëndrojnë. Po e dëmton veten dhe Kosovën, sepse ky më herët (Haradinaj) para atij (Kurtit) e ka dëmtuar veten dhe Kosovën...

Raportet me SHBA-të. Kurrë më mos u bazoni në deklaratat e kësaj qeverie

Edicioni Special: Po thoni se përfundimisht, nga këndvështrimi juaj, ka ftohje të raporteve Qeveri e Kosovës -ShBA?

Mavraj: Patjetër dhe atë shumë moti.

Edicioni Special: Qeveritarët po e thonë të kundërtën?

Mavraj: E thonë këta, e thonë...

Edicioni Special: ... por në politikë, jo gjithçka që thuhet mund të jetë ashtu...

Mavraj: Kurrë më mos u bazoni në këto deklarata, çfarëdo që

thonë. Këto deklarata janë të njëjta më kohën e atij emisarit paraprak amerikan (2020). Edhe atëherë thoshin se dy herë në ditë flasin me atë atje e dy herë në ditë me këtë zëvendësin këtu, por gjerat dolën komplet të kundërta dhe tejet të pakëndshme. Kosova veç i ka humbur shumë shanse të cilat i ka pasur më përpara... Ajo përbuzja e Marrëveshjes në Uashington... Nuk ke investime, nuk ke asnjë perspektivë për investime. Askush s'po sheh në horizont as diell as investime...

Edicioni Special: Është ndaluar korrupsioni...

Mavraj: Ku është ndaluar korrupsioni? Këta njerëz janë pasuruar shumë.

me ata që merren me politikë ose... se mund të ketë zgjedhje...

Mavraj: Personalisht jam kundër dhe kam qenë kundër gjithmonë. Asnjë qeveri asnjë mandatin nuk e ka çuar deri në fund dhe meqenëse shpresat kanë qenë të tilla, pavarësisht se Kosova e pëson shumë rëndë, personalisht jam kundër, le ta çojnë deri në fund këtë mandat. Jam edhe kundër shkarkimeve dhe dorëheqjeve edhe zgjedhjeve dhe të gjithave ato. Por, ndodh që vetvetiu bëhen të pashmangshme dhe kështu siç po shkojnë gjërat nuk habitëm edhe nëse do të ketë.

I lus emnakët e mi të mos kalojnë nëpër Serbi dhe Mal të Zi

Edicioni Special: Dhe krejt për fund z.Mavraj, mora si shkak t'iu ftojë sepse e pashë në media se ju kanë arrestuar dhe ndaluar në pikë kalimin kufitar Bullgari-Serbi...

Mavraj: Jo...

Edicioni Special: Pashë se Muhamet Mavraj ishte arrestuar nga policia,

Mavraj: Jo, jo...

Edicioni Special: ...pastaj doli një Muahmet Mavraj tjetër. Çfarë do të thotë kjo, është duke ju kërkuar Serbia, ka lëshuar fletarrest për ju?

Mavraj: Emri im është në sistemin e tyre të personave të kërkuar që nga koha e vjetër. Është edhe në Mal të Zi me sa kam njohuri. Prandaj, në Mal të Zi dhe në Serbi nuk kam shkuar kurrë pas luftës dhe nuk do të shkoj, sepse nëse shkojë të këta me ekstradojnë në Serbi, nëse shkoj në Serbi po dihet se më arrestojnë ... Por, e kanë ndaluar një kushëri, një emnak timin. Dhe, faleminderit shumë që e shtrove këtë çështje. Do të u bëja thirrje edhe nja 7-8 Muhametëve tjerë me të njëjtin mbiemër, nga vendlindja ime, pastaj nga Vrella, Jablanica, Peja, në Evropë kush ka shkuar dikush dhe njëri në ShBA që të mos kalojnë nëpër Serbi, sepse do t'i maltretojnë kot, sikurse këtë emnakun tjetër për dy-tre orë dhe mbase mund t'u dalin edhe probleme të tjera.

Edicioni Special: Ndërkohë, ju nuk do të shkoni në Serbi dhe Mal të Zi?

Mavraj: (Qesh) Nuk do të shkojë sepse e di se çfarë më pret.

Edicioni Special: Z. Mavraj faleminderit shumë që keni qenë në Edicionin Special të Klan Kosovës!

Mavraj: Respekt, faleminderit shumë!

Jam kundër zgjedhjeve të reja

Edicioni Special: A mund të ndodhë që të ketë zgjedhje? Ka njerëz në rrjetet sociale sidomos

Ministria e Tregtisë paralajmëron naftëtarët në rast të ngritjes së paarsyeshme të çmimeve

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka njoftuar se vendimi për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme dhe masat e tjera mbrojtëse ka skaduar. Lidhur me këtë, MINT thotë se në rast të rritjes së çmimeve në mënyrë të paarsyeshme do të nxirret

sërish vendim për rregullimin e çmimeve dhe masat e tjera mbrojtëse. “Në rast të rritjes së paarsyeshme të çmimeve të derivateve të naftës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë do të nxjerrë vendim për rregullimin e çmimeve dhe masat e tjera mbrojtëse sipas Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe

Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe me evidencë nga raportet ditore nga Inspektorati i Tregut, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës si dhe në konsultim me Autoritetin e Konkurrencës, Shoqatën e Naftëtarëve dhe bizneset individuale të naftës dhe konsumatorët”, ka njoftuar MINT.



Martin Berishaj s’ dëshmon në Komision Hetimor, kërkon t’i shtyhet raportimi



PRISHTINË, 11 NËNTOR - Ndonëse ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, ishte ftuar të premten ta jepte dëshminë e tij para Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ai përmes një shkresë kishte kërkuar kohë që deri më 29 apo 30 nëntor të mos ftohej për intervistim për shkak të angazhimeve.

Duke i konsideruar si të vona datat e propozuara, Komisioni i ka dhënë mundësi ambasadorit Berishaj që deri më 20 nëntor të gjejë një mundësi për intervistim. Kryetari i komisionit, Driton Selmanaj, ka lexuar një pjesë të kërkesës së ambasadorit Berishaj për shtyrje të intervistimit të tij me arsyetime se ka pasur takime diplomatike në ditën kur ishte paraparë ta jepte dëshminë e tij. “Pasi

paraprakisht kam caktuar takime me ambasadorin austriak dhe gjerman e që përputhet me datën 11.11.2022 dhe datën 12, e kam konfirmuar takimin me ministrin e Ekonomisë së Kroacisë, Dabor Filipoviç, lidhur me Forumin Ekonomik Kroaci - Kosovë që do të mbahet në javën e dytë të janarit në Prishtinë. Propozoj dhe njëherësh ju lus mirësisht që të ma mundësoni të bëj këtë

dëshmi me datën 29. 11 apo 30.11.2022 apo kur do ta caktoni ndonjë datë tjetër”, ka thënë ai. Selmanaj ka propozuar që deri më 20 nëntor ambasadori Martin Berishaj të zgjedhë se kur mund ta japë dëshminë e tij, pasi datat që ky i fundit i kishte propozuar janë të vona për shkak edhe të mandatit të komisionit. Ndërsa deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka propozuar që

për intervistim të ftohet edhe ish-udhëheqës i Njësisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë, Besim Imeri. Me këtë propozim është pajtuar edhe bashkëpartia e tij, Abelard Tahiri, i cili ka thënë se Imeri duhet të ftohet gjithsesi për intervistim pasi ai ka nënshkruar tre memorandume që kanë rezultuar në transaksionin e 20 milionë eurove të KEK-ut.

Si do t’i shkurtojë BE-ja importet ruse të energjisë?

Prishtinë, 11 nëntor - Parlamenti Evropian votoi për financimin e investimeve që do ta ndihmojnë Bashkimin Evropian t’i shkurtojë importet ruse të energjisë, duke përdorur fondet nga fondi i rindërtimit të periudhës së bllokimit Covid-19. Ligjvënësit e BE-së mbështetën planet e Komisionit Evropian për të financuar projekte të energjisë së rinovueshme, por edhe investime në lëndët djegëse fosile si gazi natyror i lëngshëm (LNG), me qëllim zëvendësimin e burimeve ruse të energjisë, transmeton dpa.

Në maj Komisioni njoftoi planet për të mbledhur deri në 300 miliardë euro (303 miliardë dollarë) kredi dhe grante për t’i rritur investimet në energjinë e rinovueshme si një përgjigje afatgjatë ndaj rritjes së çmimeve të energjisë në BE pasi Rusia pushtoi Ukrainën. Sipas propozimit të Komisionit, pjesa më e madhe e shumës deri në 225 miliardë euro do të jenë para që nuk mblidhen nga fondi “Covid-19” i BE-së. Ligjvënësit e BE-së ranë dakord për një grant shtesë prej 20 miliardë eurosh (20 miliardë

dollarë), megjithatë ata kishin pikëpamje të ndryshme nga krahu ekzekutiv i BE-së dhe shtetet anëtare se nga erdhën këto para. Sipas planeve të parlamentit, financimi prej 20 miliardë eurosh pritet të vijë kryesisht nga shitja e licencave të emetimit të karbonit për industrinë nën Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së (ETS) përpara afatit. I krijuar në vitin 2005 dhe i zgjeruar së fundmi, ETS lejon sektorët industrialë shumë ndotës të blejnë leje për emetimet që prodhojnë.



“KATAR 2022”: Hijet e një kampionati botëror që zhvillohet për herë të parë në dimër



Nga Edoardo FALZON

Botërori i këtij viti do të zhvillohet në Katar nga data 20 nëntor deri më 18 dhjetor. Është hera e parë në historinë e këtij kompeticioni, që një turne zhvillohet në stinën e dimrit, duke imponuar ndërprerjen për gati 2 muaj të gjithë kampionateve të mëdha evropiane.

Që nga vendimi, organizimi dhe në fund mbajtja e Kupës së Botës, ka shumë pikëpyetje dhe jo pak mistere që rrethojnë FIFA-n dhe Katarin, i cili ia arriti qëllimit përmes korrupsionit, lojërave politike, skandaleve dhe mijëra të vdekurve në punë.

Duke filluar që me Muhamed bin Hamam. Ish-anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FIFA-s dhe ish-president i Konfederatës Aziatike të Futbollit (AFC). I hetuar 2 herë nga organizata botërore e futbollit, fillimisht për korrupsion – në vitin 2011 tentoi të “blinte” presidencën

e FIFA-s përmes zarfeve me nga 40 mijë euro ryshfet – dhe më pas për konflikt interesi (para majit të vitit 2011 askush nuk ishte dakord që bin Hamam të ishte si president i AFC, ashtuedhe anëtar i ekzekutivit të FIFA-s).

Në vitin 2014, britanikja “The Sunday Times” pretendoi se kishte zbuluar disa ryshfete me vlerë 5 milionë dollarë, pikërisht në lidhje me kandidimin dhe zgjedhjen më pas të Katarit si vendi pritës i Kupës së Botës 2022. Por a ia vlen botërori gjithë këto shkelje?

Kështu mund të mendojnë Mishel Platini dhe ish-presidenti francez Nikolas Sarkozy. Më 23 nëntor 2010, Tamim bin Hamad Al Thani – që në vitin 2013 do të bëhet Emir i Katarit – dhe të tjerë drekuan së bashku në Elize, si të ftuar të kreut francez të shtetit.

Ndër të tjera ata u diskutua edhe për blerjen e ekipit të Paris Saint-Germain nga kompania “Qatar Sport Investment”, dhe themelimi i një kanali të ri sportiv. Fakt është

se 9 ditë më vonë, Platini do të votojë në komitetin ekzekutiv të FIFA-s në favor të zhvillimit të botërorit në këtë Emirat.

Ndërkohë vitin 2019, Platini u arrestua dhe u mor në pyetje për korrupsion, për shkak të disa konsultimeve të paguara nga FIFA në favor të tij, me vlerë 2 milionë franga zvicerane. Përfitimet kishin ndodhur ndërmjet viteve 1999–2003, por që rastësisht ishin paguar në shkurtin e vitit 2011.

Dy protagonistët e fundit të historisë janë Naser Al-Khelaifi, president i PSG-së dhe Zherom Valcke, sekretar i përgjithshëm i FIFA-s deri në vitin 2016. Arma e kriminjtë vilë në Costa Smeralda. Sipërmarrësi nga Katarin bleu në vitin 2013 Villa Bianca, ish-rezidencën e Lele Mora.

Këtu përmes një kompanie panameze off-shore, hyn në lojë Valcke, që e mori me qira vilën për shumën 96 mijë euro në vit. Pak kohë më vonë, rrjeti shtetëror BeIn bleu të drejtat për Afrikën e

Veriut dhe Lindjen e Mesme të edicioneve 2026 dhe 2030 të Kupës së Botës me një shifër qesharake dhe shumë të dyshimtë: vetëm 480 milionë dollarë. Dyshimi, i lindur nga një investigim i “L’Espresso”, është se në lojë ishte programi dimëror i këtij kompeticioni.

Mijëra të vdekurit gjatë punimeve për stadiumet e reja

Në fund të këtij turneu të madh, ata do të humbasin më shumë do të jenë njerëzit e zakonshëm. Sipas britanikes “The Guardian”, mesatarisht 12 punëtorë emigrantë nga India, Bangladeshi, Nepali dhe Sri Lanka kanë vdekur çdo javë që nga dhjetori i vitit 2010, qëkur Doha u shpall organizatore e botërorit të këtij viti.



Janë 5927 të ashtuquajturit “sklevërit modernë”, që kanë humbur jetën midis viteve

2011–2020. Sipas ambasadës pakistaneze në Katar, 824 punëtorë të vdekur duhet të shtohen në këtë llogari gjatë 10 viteve të fundit për përshtatjen dhe ndërtimin e stadiumeve të reja.

Në fakt numri i vërtetë i viktimave është dhe më i lartë, sepse deri më sot nuk mund të numërohen ende me saktësi emigrantët e shumtë nga Filipinet dhe Kenia, që kërkojnë një punë, e cila në fund u merr jetën.

Shtatë stadiume të reja, një aeroport, rrugë, transport publik, një hotel dhe madje një qytet krejtësisht i ri, që do të presë finalen e Kupës së Botës. Që të gjitha punime të kryera në më pak se 12 vjet, me çmimin e jetëve njerëzore të shfrytëzuara pa rënë në sy, dhe mbi të gjitha nën sytë e të gjithëve. Edhe nëse besoni (apo besojmë) se jemi të pafajshëm në këtë tragedi, të gjithë janë fajtorë me heshtjen e tyre. / “Opinione.it” – Bota.al





Gjinnastet e Kosovës kthehen nga Portugalia, shkëlqen Bora Hoti

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Tetë gjinnastet nga Kosova, Bora Hoti, Elena Sefa, Valëza Rama, Vilëza Zeqiri, Una Kajtazi, Fitore Rudari, Lisa Zeqiri dhe Riana Fejzullahu, janë rikthyer nga Portugalia, pasi kanë marrë pjesë në "GAIA IT WAG International Tournament 2022", të mbajtur në qytetin Porto të Portugalisë.

Bashkë me sportistet e Klubit të Gjinnastikës "Elita" ishin edhe supertrajnerët Shkumbin Maqestena dhe Abeliana Bregu. Vashat "dardane" kanë qëndruar në Portugali nga 1 nëntori deri më 7 nëntor, ndërsa paraqitjen në gjinnastikë e kanë bërë më 5 dhe 6 nëntor, derisa në mesin e shumë shteteve pjesëmarrëse është ngritur lart edhe flamuri i Kosovës.

Në Turneun Internacional të Gjinnastikës Artistike për Femra, "Gaia IT 2022", që është mbajtur në Portugali, kanë marrë pjesë më se 200 gjinnaste nga 8 shtete dhe paraqitja e mirë e gjinnasteve nga Kosova ka bërë që të ftohen edhe në garat e radhës që do të mbahen në shtete të ndryshme. Vlen të theksohet se nga garueset e Kosovës ka shkëlqyer gjinnastja




Bora Hoti e cila ka qenë shumë afër të stoliset me medalje. "Bora Hoti është sportistja që u afrua më afër zonës së medaljes, e cila, në bazë të pikëve, ku midis 36 sportistëve në Kategorinë Youth, ishte sportistja e cila mori më së shumti pikë në dy disiplina

gjinnastikore: akrobaci, 10.45p, dhe kapërcime, 11.65p. Ndërsa në katër gara ajo u pozicionua në vendin e 5-të, me 39.1p pikë, të cilat ishin shumë afër për ta fituar medaljen, pasi që vendi i 3-të dhe i 2-të ishin me 40.45p e 40.75p, kurse i 1-ri me 42.05p", thuhet në njoftimin e klubit të

Gjinnastikës "Elita". Po ashtu, edhe paraqitja e vajzave të tjera ka qenë e kënaqshme duke bërë një performancë të shkëlqyeshme në katër gara duke mbledhur pikë dhe duke dalë para garueseve të tjera që sportin e gjinnastikës e kanë traditë

shtetërore. Pjesëmarrjen e sportistëve të Kosovës në këtë garë e ka mundësuar dhe mbështetur Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës, duke ua mbuluar të gjitha shpenzimet, në kuadër të mbështetjes për sportistët e rinj.



Francisco Rivera, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me sponsorin e Superligës, "Albi Mall", kanë dhënë çmimi "Ylli i javës" edhe në këtë javë. Çmimi i më të mirit për javën e 16-të i ka

takuar futbollistit të KF Llapi, Francisco Rivera. "Jam i lumtur që e ndihmova ekipin tim për të realizuar fitore ndaj një ekipi të madh si Ballkani. Fitorja është rezultat i punës dhe angazhimit që po e bën i

tërë ekipi çdo ditë. Nuk e filluam mirë këtë kampionat, por nga ndeshja në ndeshje jemi duke u përmirësuar dhe mendoj se tashmë 11-shja më e mirë tashmë është gjetur. Në ndeshjen e fundit jemi

kuptuar shumë mirë me njëri-tjetrin. Besoj se jemi në rrugën e duhur për të realizuar fitore të tjera në mënyrë që të luftojmë sërish për kreun e tabelës, siç kemi bërë çdo vit tjetër", ka thënë Rivera.



Lista e Giressit, përplot risi

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Alain Giresse, e ka publikuar të premtën listën e futbollistëve për dy miqësoret e këtij muaji. "Dardanët" më 6 nëntor përballen me Armeninë, kurse tri ditë më vonë po në stadiumin "Fadil Vokrri" zhvillon përballjen tjetër miqësore me Ishujt Faroe. Ndryshe nga herët e tjera, Giresse për këto ndeshje ka ftuar emra të rinj, ku nuk mungojnë emrat e lojtarëve nga

Superliga e Kosovës. Futbollistët nga kampionati vendor që do të jenë pjesë e Kosovës janë: Ilir Krasniqi (Llapi), Lindon Emërllahu dhe Lumbardh Dellova nga Ballkani dhe Muharrem Jashari (Drita). Giresse ka ftuar edhe lojtarë që kanë luajtur më pak, por edhe në ekipet e moshave në të kaluarën si Leard Sadriu, Jetmir Topalli, Valmir Veliu dhe Mirlind Daku. Kosova stërvitet e parë e zhvillojnë të hënën në orën 18:30 në stadiumin "Fadil Vokrri".



Lista e futbollistëve:

Visar Bekaj, Jozef Pukaj, Ibrahim Dresheviq, Lirim Kastrati, Ilir Krasniqi, Jetmir Haliti, Donat Rrudhani, Lumbardh Dellova, Leart Sadriu, Uran Bislimi, Lindon Emërllahu, Muharrem Jashari, Blendi Idrizi, Jetmir Topalli, Toni Domgjoni, Agon Sadiku, Arianit Ferati, Valmir Veliu, Mirlind Daku, Lirim Kastrati.

Sonte ballafaqohen Trepça - Rahoveci



MITROVICË, 11 NËNTOR - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e dhjetë e Prince Caffë Superligës. Takimi i parë dhe i vetëm i së shtunës zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Rahovecit. Skuadra mitrovicase ka pesë fitore dhe tri humbje, ndërsa ajo rahovecase është në krizë me një fitore e tetë humbje (radhazi). Fitorja është e vlefshme për të dyja skuadrat që kanë ambicie të kundërta në këtë edicion. Vëllaznimi që ka ngritje të formës do të ndeshet me Sigal Prishtinën. Kuqezinjtë kanë

katër fitore e pesë humbje, kurse ajo prishtinase pesë fitore e katër humbje, andaj pritet një ndeshje interesante, ndërsa palestra 'Shani Nushi' në Gjakovë pritet të jetë e mbushur me adhurues të basketbollit. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje zhvillohet në mes të skuadrave prizrenase, Ponte Prizrenit dhe Bashkimit. Ponte ka tri fitore e katër humbje, kurse Bashkimi tri fitore e gjashtë humbje. Tifozët prizrenas kanë rastin të shohin një përballje të bukur në "Sezai Surroi". Për ndeshjen Golden

PRINCE CAFFE SUPERLIGA - JAVA 10

Të shtunë takohen:

19:00 Trepça - Rahoveci

Të dielën takohen:

17:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina
19:00 Ponte Prizreni - Bashkimi
Golden Eagle Ylli - Peja (Rezultati i Ligës Unike)

Eagle Ylli - Peja do të regjistrohet rezultati nga Liga Unike.

Miami rikthehet te fitorja, humbasin Philadelphia dhe Dallasi

MIAMI, 11 NËNTOR - Miami rikthehet te fitorja në kampionat, duke mundur me rezultat 117-112 Charlotten, ndeshje e vendosur pas kohës shtesë. Një sfidë e ekuilibruar mes dy skuadrave që synojnë një vend në zonën "play-off". Ndeshje mjaft e mirë e Jimmy Butlerit, që realizoi 35 pikë e 10 rebounde për Miamin, duke i bërë të pavlefshme 29 pikët e Oubres për miqtë.

Zhënjën skuadra e Philadelphias, që pësoi humbje nga Atlanta (104-95), të shtatën sezonale. Embiid realizoi 26 pikë e 13 rebounde për miqtë, por që mbetën për statistikë. Të gjithë titullarët e Atlantës realizuan mbi 10 pikë, ku u dalluan Youngu

me 26 pikë e Capela me 18 pikë e 20 rebounde.

Fitore të lehtë korri Washingtoni ndaj Dallasis (113-105). Dinwiddie me 33 pikë e Donviqi me 22 u përpoqën ta mbajnë në lojë Dallasin, por pa sukses. Kuzma me 36 pikë e 11 rebounde ishte lider për vendasit. Ekipi i Portlandit, falë 27 pikëve të Grantit e 23 të Simonsit, mundi me shifrat 106-95 New Orleans (Williamson 29 pikë).

REZULTATET

Washington - Dallas	113-105
Atlanta - Philadelphia	104-95
Miami - Charlotte	117-112
New Orleans - Portland	95-106





Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
 Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 11.11.2022 bënë shpallje publike:

NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-22-07

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e zyrave në Terminalin doganor dhe deponë në Industrinë baterive.

Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë

Numri i ofertave të pranuar: 20(njëzet)

ME KONTRATË SHPËRBLEHET

- Loti 1 Zyre 10 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – NANI Impex
- Loti 2 Zyre 11 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – ServisShped
- Loti 3 Zyre 12 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Mondi Shped
- Loti 4 Zyre 13 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Auto Shped
- Loti 5 Zyre 14 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Rahova Shped
- Loti 6 Zyre 15 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Fitimi Shped
- Loti 6 Zyre 15 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Eni Shped
- Loti 7 Zyre 16 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – IDEAL SHPED
- Loti 9 Zyre 18 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Germova 2
- Loti 10 Zyre 19 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – GIMA1
- Loti 11 Zyre 20 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – BKS
- Loti 12 Zyre 21 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Proka
- Loti 13 Zyre 22 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – ARS SHPED
- Loti 14 Zyre 23 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Flonja
- Loti 14 Zyre 23 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – A shped
- Loti 15 Zyre 24 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Real Shped
- Loti 16 Zyre 25 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Alpha shped
- Loti 17 Zyre 26 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Asllan & Sons
- Loti 18 Zyre 27 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – BOBI FLJ
- Loti 21 – deponë në Industrinë baterive çmimi me TVSH 1,500.00 -NTSH -Dega në Kosovë

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 16.11.2022 ora 10:00

NJOFTIM PËR ANULIM : T-22-07

Lot 8, 19 dhe 20 Anulohen për shkak të mos pranimit të asnjë oferte:

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Cdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Drejtësisë - Ministraskvo Pravde - Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 10.11.2022
 011/2022

Referenca: AAPSK –

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Rimorkio Trailor S33 EN 14, ngjyre e hirit për skrap	1 copë për skrap	1,300.00€		
2	VW Golf 2, viti i prodhimit 1985, ngjyre e hirit-për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
3	VW Golf 2, viti i prodhimit 1989,benzin, ngjyre e kalter -për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
4	VW Golf 2, viti i prodhimit 1989,benzin, ngjyre e kalter -për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
5	VW Golf 3, ngjyre e gjelber-për skrap	1 copë për skrap	300.00€		
6	Furgon- Mercedes Benz 312, viti i prodhimit 1999,ngjyre e bardhë -për skrap	1 copë për skrap	400.00€		
7	Rimorkio pa targa- për skrap.	1 copë për skrap	200.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 17.11.2022 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-e) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 17.11.2022, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se „në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051

Oferte për shitjen e patundshmerise

Zija (Gjimshiti) Bilalli nga Dragashi (Brrut) me adres banimi Rr. Meleq Begu nr.23 Prizren i cili është bashkepronar ne pjesen prej 1/2 e pjeses ideale te patundshmeris , me numer te Njesis kadastrale P- 71813068 - 02460 -0 ne vendin e quajtur " Partizani " Toke ndertimore 239m2 obor dhe 1.90m2 shtepi - Ndertese , me siperfaqe te pergjithshme prej 429m2 zona Kadastrale Prizren.

Nga pjesa e vet ideale ofron per shitje siperfaqen e pergjithshme prej 214.5 m2 (apo 1/2 e pjeses ideale) te patundshmerise me te dhenat si me lart, ne shumen e pergjithshme prej 250.000 (me shkronja : Dyqinde e Pesedhete Mij euro) , Prizren . 11.11.2022

Ofertuesi :
Zija (Gjimshiti) Bilalli

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- D.P.H "ABA" Ilir Tuli B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330279621.

- Mishtore "Meli" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811932038.

- Dr. Azem Spahiu shpall të pavlefshme Licencën e Mjekësisë Familjare të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës me nr. KO-00787-01-21 datë 24.11.2017/ 24.11.2022.

- Dren Ahmeti shpall të pavlefshme diplomën e masterit-it, të FNA-së, Prishtinë.

- Lumturije Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Borë Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M "Selman Riza", nga klasa e -I- deri -VIII-, Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -IX- të SH.M.T "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

